

EKO SHKOLLA

- REDUKTO - RIPËRDOR - RICIKLO -

EKO KLUBI
"LUCIANO MOTRONI"





Të dashur lexues,


Kjo është seria e tretë e buletineve mjedisore të eko-klubeve të shkollave të mesme nga Rajoni i Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës). Ky është buletini i parë informativ, i cili do të përmbajë mesazhe, intervista, ese, punime fotografi dhe shkrime të ndryshme mbi mjedisin dhe ndryshimet klimatike dhe njoftime mbi punën që po zhvillohet në këto tema nga eko-klubi i Shkollës së Mesme të Lartë "Luciano Motroni" dhe OJQ EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "ECO School".

Ky projekt do t'i njohë me konceptin "Eko Shkolla" 12 shkollat e rajonit të Jugut (komuna e Prizrenit, Mamushës, Rahovecit dhe Malishevës), përmes pilotimit të formave dhe metodologjisë për mbrojtjen e mjedisit me pjesëmarrje të gjerë të nxënësve dhe mësimitdhënësve.

Në kuadër të projektit ofrohet një model dhe metodologji që përdoret gjerësisht në vendet e zhvilluara, e cila po zgjerohet me shpejtësi edhe në vendet në zhvillim. Përvojat botërore tregojnë se shkolla ekologjike është një fenomen në rritje, e cila nxit të rinjtë të angazhohen në mjedisin e tyre duke u dhënë atyre mundësinë për ta mbrojtur atë në mënyre aktive.


Projekti po ashtu do të kontribuojë në Strategjinë e Mjedisit dhe Planin e Veprimit në Mjedis të Kosovës, duke rekomanduar zhvillimin e programeve për edukimin mjedisor në të gjitha nivelet (shkolla dhe universitete).

MJEDISI MUND TË JETOJË PA NE, POR NE JO PA TË...



Ambienti është ai në të cilin njeriu zhvillon veprimtarinë e tij jetësore dhe pa të, ai nuk do të mund të ekzistonte. Duke u fokusuar tek mënyra se si të fitojë më shumë para, njeriu po e anashkalon kujdesin ndaj ekuilibrave natyrorë. Me ndotjen e tokës, ujit dhe ajrit, dëmtohen e gradualisht shkatërrohen ekosistemet dhe habitatet natyrore të kafshëve dhe bimëve. Dëmtimi i florës dhe faunës, njëkohësisht sjell përkeqësimin e gjëndjes së mjedisit dhe cilësisë së jetës. Duke parë rëndësinë e mjedisit, lind nevoja e madhe për mbrojtjen e tij. Në Shqipëri rastet e ndotjes së mjedisit janë të pafundme. Njeriu e shfrytëzon tokën në favor të interesave të tij, ku gjatë përdorimit ka dhe disa kosto mjedisore, të cilat duhen minimizuar në maksimum.

MJEDISI MUND TË JETOJË PA NE, POR NE JO PA TË...



Ndotja e tokës paraqet ndotjen e sipërfaqes natyrore të Tokës nga aktivitetet industriale, komerciale, shtëpiake dhe bujqësore. Mënyra më e mirë për të parandaluar ndotjen e tokës është përmes menaxhimit të mbeturinave në mënyrë të organizuar, shfrytëzimit të tokës në mënyrë të organizuar dhe praktikave adekuate bujqësore. Në vendin tonë rastet e ndotjes së tokës janë të shumta. Jo të gjithë njerezit e institucionet veprojnë njelloj ndaj mjedisit. Disa zhvillojnë veprimtari mbrojtëse ndërsa të tjerë e shfrytëzojnë në mënyrat më barbare të. Ruajtja dhe kujdesi për mjedisin nuk është vetëm një detyrim shoqëror, por mbi të gjitha është dhe një përgjegjësi individuale.

Mjedisin është i të gjithëve dhe të gjithë duhet ta mbrojnë e atë. Shoqëria si në vendin tonë ashtu edhe në mbare botën po përballë me problem të mëdha që lidhen me mjedisin si: ndotja, prishja e ekuilibrit të ekosistemeve, shfrytëzimi pa kriter i burimeve natyrore etj.


CIKLI I UJIT!



Është procesi i vazhdueshëm i qarkullimit të ujërave në natyrë, mbi dhe nën sipërfaqen e Tokës. Sasia totale e ujit në sipërfaqen e Tokës qëndron e njëjtë me kalimin e kohës, megjithatë raporti i sasisë së ujit në tre gjendjet kryesore: i ngurtë (akullnajat), i lëngshëm (lumenjtë dhe oqeanet) ose i gaztë (avujt atmosferikë) ndryshon në bazë të stinëve dhe kushteve klimaterike.

Cikli i ujit, si proces fizik, përfshin transmetimin e energjisë, gjë që rezulton në ndryshime në temperaturën e mjedisit përreth, dhe si rezultat, ndikime dhe në klimë. Për shembull, gjatë avullimit, uji përthith energji nga mjedisi rrethues, duke ulur kështu temperaturën atmosferike. Gjatë kondesimit, avujt çlirojnë energji që përthithet nga mjedisi rrethues, proces i cili ndikon në rritjen e temperaturës.

Mjedisi është i të gjithëve dhe të gjithë duhet ta mbrojnë atë. Shoqëria si në vendin tonë ashtu edhe në mbarë botën po përballet me probleme të mëdha që lidhen me mjedisin si: ndotja, prishja e ekuilibrave të ekosistemeve, shfrytëzimi pa kriter i burimeve natyrore etj.



DITA NDËRKOMBËTARE E PYJEVEË

Në Ditën Ndërkombëtare të Pyjeve, projekti “Ndikimi i Rinisë në Mjedis” (#YENI) organizoi një vizitë edukativo-mjedisore për Eko Klubet e shkollave partnere të Prizrenit në Vend Gjuetinë me Rëndësi të Veçantë në Blinajë të Lipjanit. Blinaja përfshin rreth 3 mijë hektarë dhe dallohet me faunë të egër e shpezë (përfshirë kaproj, dre, derra të egër, dhelpra, shqiponja etj.), bimë të llojllojshme, e rreth 30 liqene.





TAKIM I EKO-KLUBIT ME OJQ EC MA NDRYSHE



PUNËTORIA E EKO KLUBIT PËR PLANET MJEDISORE



GO GREEN, SAVE THE PLANET!

Finesa e njeriut kurrë nuk do të dëshmojë një shpikje më të bukur, më të thjeshtë, ose më të drejtpërdrejt se sa e bën natyra, sepse në shpikjet e saj asgjë nuk mungon dhe asgjë nuk është e tepërt.
Me respekt:

Mehdi Krasniqi, drejtor!



EKO KLUBI "LUCIANO MOTRONI" RR. MEHMET PASHË DEVALLA – PRIZREN, KOSOVË

Autor dhe botues: EC Ma Ndryshe
Rr. Fehmi Lladrovci Nr.94, Prizren & Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7,
Prishtinë
www.ecmandryshe.org
info@ecmandryshe.org
029 222 771 & 038 224 967

Ky buletin u realizua në kuadër të projektit "Ndikimi i Rinisë në Mjedis" - YENI, i cili bashkëfinancohet nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, Caritas-i Zviceran, Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe implementohet nga OJQ EC Ma Ndryshe përmes projektit "ECO Schools".